

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Mehmet Ndrecaj, me procesmbajtësen Shyhrete Sopaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit N. E. nga fshati komuna e Prizrenit, për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën. par. 1.1 të KP-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.1521/16, dt.24.05.2016, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, në prani të prokurorit Zejnullah Gashi, të dëmtuarit R. K. të akuzuarit N. E. dhe mbrojtësit të tij av, R. H. nga Prizreni me dt.30.12.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë;

A K T G J Y K I M

I akuzuari;

N. E., me pseudonimin "C", nga i ati N., e ëma S., mbiemri i vajzërisë I., i lindur me , në Prizren tani jeton në fshatin komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, me kushte të mira ekonomike, shqiptar shtetas i R. së Kosovës.

Në bazë të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP;

L I R O H E T N G A A K U Z A

SE; Me dt.05.06.2016, në mes të orës 20:00 -21:30 minuta, në fshatin komuna e Prizrenit, në shtëpinë e të dëmtuarit R. K. i pandehuri në bashkëveprim edhe me të miturin E. S., duke thyer, kaluar apo dëpërtuar me forcë në hapësirat e mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së të dëmtuarit, në atë mënyrë që shfrytëzon momentin e volitshëm, mos prezencën e të dëmtuarit i afrohet shtëpiës së të dëmtuarit, kalon murin - rrethojen e oborrit të shtëpiës në lartësi rreth 2 metra, ku i mituri bënte roje, kurse i pandehuri me mjet të përshtatshëm dhe me forcë e hap një dritare në pjesën anësore të anës së majtë të shtëpisë dhe nga njëra dhomë e gjumit merr stoli të arit: 7 (shtatë) lira, 1 (një) zingjirë qafe, 1 (një) medaljon, 2 (dy) rrathë të dorës, 5 (pesë) unaza, 1 (një) komplet ari, si dhe dy kartëmonedha nga 500 (pesëqin) euro gjithësej 1000 (një mijë) euro, dhe largohet nga vendi i ngjarjes, me qrast të dëmtuarit i shkakton dëm material në shumën prej 8000 (tetë mijë euro).

Me këtë kishte për të kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën.par.1.1 të KP-së.

I dëmtuari R. K. nga fshati komuna e , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civilo-juridik.

Shpenzimet procedurale penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, në Gjykatës Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzë PP.nr.1521-2/16, dt.24.08.2016, ndaj te akuzuarit N. ... E. ... nga fshati ... komuna e Prizrenit, nën dyshimin se në bashkëveprim me të miturin Edison Susuri, ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga nien 327 par.1 nën.par. 1.1. të KP-së.

Prokurori i Shtetit në shqyrtimin gjyqësor në fjalën përfundimare ka deklaruar se: qëndroj pranë aktakuzës PP/II nr. 1521-2/16 të datës 24.08.2016 kundër të akuzuarit N. ... E. ... për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par. 1 nën. par. 1.1 të KP-së, këtë e bazoj nga administrimi i provave, gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor dhe veçanarishtë nga deklarata e dëshmitarit E. ... S. ... i cili është i mitur, mirëpo bashkëkryes me të akuzuarin N. ... i cili si dëshmitar është shumë kredibil, sepse përshkruan në mënyrë të hollësishme dhe në detaje mënyrën e kryerjes së veprës penale të vjedhjes së rëndë duke kaluar pengesat - rrethojen në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit, përshkruan me saktësi që nga pjesa e pasme e shtëpisë përmes dritares është futur i akuzuari N. ... dhe pas kryerjes së veprës penale të vjedhjes i njëjti ka dal nga dritarja e pjesës së përparme të shtëpisë të cilat këto prova janë në përputhje të plotë me fotografimin dhe skicimin nga vendi i ngjarjes të njesitit të forenzikës. Andaj këtyre provave gjykata duhet në plotëni t'ua fal besimin. Ndërsa sa i përket deklarimeve dhe tentimit të akuzuarit të familjares N. ... E. ... dhe dhëndërrit dëshmitarit E. ... M. ... për alibi se në natën kritike i akuzuari ka qenë në shtëpi se i ka bartur gjësendet e blera në "ETC", kjo është mohuar tërësisht nga deklarata e dëshmitarit - taksistit D. ... A. ... bashkëfshatarit të akuzuarit i cili ka mohuar në tërësi se në natën kritike i akuzuari i ka bartë gjësendet e blera në "ETC", dhe ky tentim për alibi është bërë me qëllim të shmangies së tij nga përgjegjësia penale. Andaj i propozoj gjykatës që ta shpall fajtor të akuzuarin N. ... E. ... dhe ta denoj sipas ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e denimit gjykata të marrë parasysh rrethanat lehtësuese se i njëjti është i moshës relativisht të re, mirëpo si rrethanë rënduese të ketë parasysh vlerën e atakuar dhe mënyrën dhe rrezikshmërinë e kryerjes së kësaj veprë penale e qa më tepër se që në kohën e fundit është një numër i jashtëzakonshëm i madh i kësaj dukurie të kësaj natyre të veprave penale.

I dëmtuari R. ... K. ... në shqyrtimin gjyqësor në fjalën përfundimtare ka deklaruar se do të parashtoj kërkesë pasurore- juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. R. ... H. ... nga Prizreni në shqyrtimin gjyqësor në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e kundërshtoj aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prizren kundër N. ... E. ... i cili ngarkohet për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë në dëm të dëmtuarit R. ... K. ... si dhe fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit. Provat në të cilët mbështet aktakuza jo se nuk janë kredibile e as dëshmitari nuk është kredibil, por është provë e imagjinuar e dëshmitarit, për të cilën dëshmi nuk mund të dij se cilat janë motivet dhe shkaqet për ta ngarkuar N. ... E. ... se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale. Për tu kryer vepra penale e vjedhjes së rëndë kryerësit duhet të hartojnë një planë në të cilin parashohin kohën, mënyrën dhe vendin e kryerjes. Në plan parashihet se cila është mënyra më e volitshme në rastin konkret a ekzistojnë kushtet për kryerjen e veprës penale, a ka anëtarë të familjes në shtëpi, cilat sende do ti vjedhin dhe a ka pengesa për kryerjen e veprës penale. Sipas dëshmisë së dëshmitarit E. ... S. ... ai është takuar rastësisht me të akuzuarin N. ... E. ... Nëse analizohet kjo metodë e kryerjes së veprës penale kinse N. ... E. ... e ka hartu planin, e ka ditë shtëpinë ku do të kryhet vepra, ka ditë çka duhet të marrë, të gjitha këto sipas E. ... , por nëse analizohen deklaratat e tij në polici, prokurori dhe

144

në shqyrtimin kryesor këto deklaratat janë diametralisht të ndryshme, njëra me tjetrën dhe nuk korespondojnë. Në deklaratën e dhënë në polici E. S. ka deklaruar se ka qenë duke çëndruar te një market afër xhamisë në pjesën e të Ri, dhe në atë kohë ka ardhë N. dhe i ka thënë hajde të shkojmë te shtëpia e R. K. se aty ka dukat dhe pare dhe du mi vjedh. Në deklaratën e dhënë në prokurori ai e ndryshon vendqendrimin dhe thotë: me Nesimin jemi taku në stacionin policor në dhe bashkërisht kemi shkuar dhe e ka përshkruar mënyrën e kryerjes thotë se Nesimi ka hyrë nga dritarja e pasme dhe ka dal nga dritarja përpara shtëpisë dhe jemi larguar rrugës së njëjtë. Në seancën kryesore me rastin e dëgjimit të dëmtuarit R. K. ka deklaruar se nga ana e përparme shtëpisë nuk ka pasur dritare të hapura, prandaj deklarata e E. S. sipas bindjes së thellë është e pa vlerë sepse këtë deklaratë ose e ka dhënë me dhunë por jo nga organet hetimore, sepse sipa mendimit tim ai e din se më kë e ka kryer veprën penale, por nga frika nuk është në gjendje të tregoi realitetin. Në lidhje me alibin të cilin prokurori e kundërshton mendoj se alibi i N. E. se në natën kritike ka qenë në shtëpinë e vetë me familjar, është e vërtet sepse dëshmitarët të cilët kanë dëshmuar, gjyqtari u'a ka tërheq vërejtjen se dëshmia e rrejshme është vepër penale, prandaj mendoj se dëshmitarët N. E., E. S., M. dhe K. M. e kanë thënë atë qka kanë përjetuar dhe qka kanë ditur. Kështu N. E. në shtëpinë familjare të N. E. ka çëndruar prej orës 18:00 gjer në ora 2:30 në syfyr dhe ajo ka dëshmuar se Nesimi gjatë tërë kohës ka qëndruar në shtëpi, me përjashtim te një momenti kur është larguar për 10-15 minuta, mirëpo nuk ka mundur të tregoi se ku ka shkuar. Elbasan Memaj ka deklaruar se Nesimi ka qenë në shtëpi dhe me të ka qenë deri në ora 24:00 dhe në fund Kasam Memaj pronari i bastores në fshatin ka dëshmuar se N. E. në bastore ka shkuar rreth orës 21-22:00 e ka plotësuar një tiket prej 5 eurosh dhe ka shkuar, kjo kohë përputhet me deklaratat e Nailes dhe Elbasanit. Prandaj alibi është mëse i vërtet ngase i akuzuari N. E. në të njëjtën kohë nuk ka mundur me qenë në dy vende edhe në shtëpi edhe në objektin ku është kryer vepra penale. Nga fotografit e vendit të ngjarjes të dhomave të shtëpisë së të dëmtuarit R. K. qartazi shifet demolimi i tërësishëm i të gjitha dhomave dhe gjësëndeve që kanë nëpër dhoma dhe shtrohet pyetja se a është e mundur një person për 20 minuta me bërë atë rrëmujë nëpër dhoma të shtëpisë po del se jo ku kam dhënë edhe vërejtje në atë procverbalin e shiqimit të vendit të ngjarjes ngase nuk janë evidentuar të gjitha gjurmët si në oborr, bashqe dhe nëpër dhoma të shtëpisë. I propozoj gjykatës që në mungesë të provave të merr aktgjykim lirues në kuptim të nenit 364 par.1 pika 3 të KPP -së ngase i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale.

I akuzuari N. E. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore janë dëgjuar në cilësinë e dëshmitarëve i dëmtuari Ramiz E., N. E., E. S., K. M. dhe E. E. me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike.

I dëmtuari R. K. ka deklaruar se: Ka qenë dt. 05.06.2016, deri në ora 19,00 kam qenë në punë në Spitalin e Prizrenit. Në ora 19,30 kam shkuar në shtëpi. Në shtëpi nuk ka qenë askush, fëmijët, respektivisht familjarët e mi kanë qenë tek prindërit e bashkëshortes. Në mbrëmje rreth 15 minuta kur jam kthyer kam ngrënë darkë, në atë moment më ka thirrë vëllai në telefon për të më treguar që nëna është e sëmurë. Rreth orës 20,30 jam nisur për në fshat brenda, ngase unë jetoj jashtë fshatit, ngase është Z. i ri, në rrugë e sipër jam takuar me -

vëllain, ngase prapa shtëpisë sime gjendet motra ime me shtëpi dhe nëna ka shkuar që ta merr injeksionin në atë shtëpi. Kjo procedurë ka zgjatur një orë. Në këtë afat prej një orësh e kam pirë një kafe dhe kam shkuar tek berberi dhe në ora 21,30 kam shkuar në shtëpi. Kur kam hyrë në shtëpi, shtëpia ka qenë e tollovitur brenda mirëpo xhamat e jashtme kanë qenë të hapura. E kam lajmëruar policinë, kanë ardhur policia, tjetër nuk kam qka të deklaroj.

Dëshmitarja N. E. nga fshati komuna e Prizrenit (bashkëshortja e djalit të xhaxhait të akuzuarit) ka deklaruar se: unë atë ditë me dt. 05.06.2016, kam qenë në shtëpinë e Nesimit, Nesimi ka qenë në shtëpi prej orës 6 në mbrëmje unë kam qenë aty ku kam qëndruar deri në 2,30 të natës se ka qenë koha e syfyrin. Atë ditë N. ka qenë në shtëpi, motrat e tij kanë shkuar të blejnë gjësende në Prizren, në orën 10 janë kthyer nga Prizreni, pas kësaj N. ka dalë për të ndihmuar për t'i bartur gjërat që i kishin blerë. Në ora 23,00 Nesimi ka dalë në oborr, 15 minuta nuk ka zgjatur dhe prap u kthye në shtëpi. Tjetër nuk kam qka të deklaroj.

Dëshmitari E. M. nga fshati komuna e Prizrenit (dhëndëri i të akuzuarit) ka deklaruar se: Nga ora 18, deri në ora 22, kam qenë bashkë me N. në shtëpinë e Nesimit, mandej nga aty kam shkuar për t'i marrë motrat e N. në qendrën ETC me një taksist, fshatar tonin. Kur jemi kthyer N. ka qenë në shtëpi, ka dalë na ka ndihmuar rreth gjësendeve që i kemi blerë, dhe Nesimi ka kërkuar nga motrat të holla rreth 5 euro, për ta mbushur një tiketë të bastores dhe brenda 10 minutave është kthyer, unë kam qenë deri në ora 24 aty. Tjetër nuk kam qka të deklaroj.

Dëshmitari i mituri E. S. si bashkëkryes i veprës penale ka deklaruar se: Në ditën kritike N. ka qenë duke ardhur nga qendra e fshatit Z. më tha mua a po vjen se R. nuk është në shtëpi, unë i thash jo nuk po vij mandej shkova me të por jo me qef, shkua aty i kemi kapërcyer muret dhe N. më tha rri këtu e vet hyri nga dritarja e pasme e shtëpisë, nuk ka shkuar as 20 minuta dhe i njëjti ka dalur nga shtëpia, mandej e kemi kapërcyer murin dhe kemi dalur në rrugën kryesore. Mua më tha ti shko në shtëpi e N. se ku ka shkuar nuk e di. Nuk kam vërejtur asgjë dhe nuk e di që ka pasur diçka ai pasi ka dalur nga shtëpia.

Dëshmitari: D. A. në pyetjet e palëve ka deklaruar se: në ditën kritike ka qenë me motrat dhe me dhëndrrin e të akuzuarit duke shkuar në "ETC" dhe se në market kanë qëndruar diku rreth 40 minutash deri në 1 orë dhe është kthyer me ta në shtëpi ka qenë errësirë dhe se familjarët e të akuzuarit kanë dalur për ti bartur gjësendet e blera, të akuzuarin nuk e kam parë që ka dal për ti bartur gjësendet.

Dëshmitari: K. M. nga fshati Z. komuna e Prizrenit në pyetjet e palëve ka deklaruar se deri para dy jave kam punuar në bastore sportive si punëtor tash jam i pa punë, dhe e njoh N. E. dhe se i njëjti në natën kritike ka qenë në bastore rreth orës 21-22 dhe e ka plotësuar një tiket por të hollat nuk mi ka paguar më ka thënë se ti jap më vonë, në bastore nuk ka pasur kamera të vendosura dhe se tiketa nuk ekziston, policia kanë qenë në bastore më treguan për rastin dhe më pyetën se a dyshoj unë për ndonjë person më pyetën për N. se a ka qenë në bastore i thash se po ka qenë pas dite një ditë para. Më treguan që është thyer shtëpia e R.

Në seancën gjyqësore janë lexuar provat materiale si raportet e oficerit nr. 2016-GA-1445 të dt. 05.06.2016, 28.06.2016 dhe 11.07.2016, raporti i ekzaminimit njësia Afis në Prizren, raporti i kqyrjes së vendit të ngjarjes të dt. 05.06.2016, fotoalbumi i dt. 05.06.2016.

Nga leximi i raporteve të oficerit, gjykata nuk ka vërtetuar ndonjë fakt që mund të ndihmonin gjykatën për të marrë aktgjykim tjetër, por në mënyrë kronologjike përshkruhet ngjarja rreth veprës penale dhe përmenden disa emra si të dyshuar të mundshëm të kryerjes së kësaj vepre.

Nga leximi në raportin e ekzaminimit Njesia Afis në Prizren dt. 07.06.2016, është vërtetuar fakti se gjurmët e panjohura të vijave papilare të gishtit të dorës D1, janë ekzaminuar me zmadhues dhe është gjetur se janë të papërshtatshme për krahasim dhe identifikim të metejshëm, gjurmët të panjohura të vijave papilare të gishtit të dorës D2, janë ekzaminuar me zmadhues dhe është gjetur se janë të përshtatshme për krahasim dhe identifikim të metejshëm, është bërë krahasimi eliminimi i gjurmëve latent të gjetura në vendin e ngjarjes, me shenjat e gishtërinjëve të E. K., ku është konstatuar se gjurmët latent të gjetura në vendin e ngjarjes, me shifrën D2, janë të njëjta me gishtin nr. 6 gishti i madh i dorës së majtë të viktimës Esma Kabashit.

Nga leximi i raportit të kqyrjes së vendit të ngjarjes dt.05.06.2016 nga parashtruesi i raportit është pasqyruar në tërësi vendi apo ngjarja e kryerjes së veprës penale, në lidhje me vendin, kohën dhe të gjeturat në vendin e ngjarjes.

Nga fotoalbumet e bëra në vendin e ngjarjes dt.06.06.2016 vërehet pamja e shtëpisë, mureve të oborrin dhe dritareve të dëmtuara, koridori dhe dhomat e demoluara të shtëpisë.

I akuzuari në mbrojtjen e tij, gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se: Atë ditë kam qëndruar tërë ditën në shtëpi, ku i kam edhe fotot që rreth orës 17,00 dhe një foto në orën 23,00 pas dite, unë atë ditë nuk jam takuar me atë djalë dëshmitarin E. K. Susuri, që deklaroi se kinse unë jam bashkëkryerës i kësaj vepre dhe kinse e kam marrë me detyrim. Me dt. 28.06.2016 kam dhënë deklaratën në njësinë hetuese të policisë, e në letër shkruan kinse unë kam dhënë deklaratë në Stacionin e policisë në Prizren, por unë atë ditë nuk kam dhënë deklaratë në Stacionin e policisë në Prizren por në Stacionin e Prizrenit. Qëndroj pranë deklaratës që kam dhënë në polici. Me E. K. kam pasë një rast në vitin 2015, kur ai ka ardhë të shkolla e Z. K., ka ardhë për të më thënë që t'ia shes një hallkë të dorës, unë ia kam shitur atë hallkë, kam gabuar dhe e kam pranuar gabimin edhe atëherë ka thënë njëjtë sikur se tash që ka dëshmuar në gjykatë.

Pas procedimit të provave në këtë shqyrtim gjyqësor, dëgjimit të dëshmitareve, marrjes në pyetje të të pandehurit dhe të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera gjykata në mbështetje të nenit 361 të KPP-së, ka vlerësuar se akuza nuk është provuar me prova materiale nga ana e Prokurorisë së akuzuari ka kryer veprë penale për të cilën akuzohet.

Nga provat personale - dëshmitarët e dëgjuar në këtë çështje nuk janë vërtetuar veprimet konkrete të akuzuarit në lidhje me veprën penale të të cilën ngarkohet kjo konstatohet nga dëshmitë e dëshmitareve: N. K. E. K. e cila ka deklaruar se: unë atë ditë me dt. 05.06.2016, kam qenë në shtëpinë e N. K., Në shtëpi ka qenë në shtëpi prej orës 6 në mëngjes unë kam qenë aty ku kam qëndruar deri në 2,30 të natës se ka qenë koha e syfyrit. Atë

ditë Nesimi ka qenë në shtëpi, motrat e tij kanë shkuar të blejnë gjësende në Prizren, në orën 10 janë kthyer nga Prizreni, pas kësaj Nesimi ka dalë për të ndihmuar për ti bartur gjërat që i kishin blerë. Në ora 23,00 Nesimi ka dalë në oborr, 15 minuta nuk ka zgjatur dhe prap u kthye në shtëpi. Dëshmitari Elmasri Memari ka deklaruar se: Nga ora 18, deri në ora 22, kam qenë bashk me Nesimi në shtëpinë e Nesimit, mandej nga aty kam shkuar për ti marrë motrat e Nesimit në qendrën ETC me një taksist, fshatar tonin. Kur jemi kthyer Nesimi ka qenë në shtëpi, ka dalë na ka ndihmuar rreth gjësendeve që i kemi blerë, dhe Nesimi ka kërkuar nga motrat të holla rreth 5 euro, për ta mbushur një tiketë të bastores dhe brenda 10 minutave është kthyer, unë kam qenë deri në ora 24 aty. Dëshmitari: D. A. ... në pyetjet e palëve ka deklaruar se: në ditën kritike ka qenë me motrat dhe me dhëndrrin e të akuzuarit duke shkuar në "ETC" dhe se në market kanë qëndruar diku rreth 40 minutash deri në 1 orë dhe është kthyer me ta në shtëpi ka qenë errësirë dhe se familjarët e të akuzuarit kanë dalur për ti bartur gjësendet e blear, të akuzuarin nuk e kam parë që ka dal për ti bartur gjësendet Dëshmitari: K. ... Memari nga fshati ... komuna e Prizrenit në pyetjet e palëve ka deklaruar se deri para dy jave kam punuar në bastore sportive si punëtor tash jam i pa punë, dhe e njoh Nesimi Elmasri dhe se i njëjti në natën kritike ka qenë në bastore rreth orës 21-22 dhe se e ka plotësuar një tiket port ë hollat nuk mi ka paguar më ka thënë se ti jap më vonë, në bastore nuk ka pasur kamera të vendosura dhe se tiketa nuk ekziston dhe se policia kanë qenë në bastore më treguan për rastin dhe më pyetën se a dyshoj unë për ndonjë person më pyetën për Nesimin se a ka qenë në bastore i thash se po ka qenë pas dite një ditë para. Më treguan që është thyer shtëpia e Ramizit, andaj dëshmitë e dëshmiareve te theksuara si me larte, nga përmbajtja e tyre nuk e ndërlidhin te akuzuarin Nesimi Elmasri me ndonje dëshmi konkrete per veprën penale për të cilën akuzohet.

Deklarata e bashkëkryersit të veprës penale të miturit E. ... S. ... i cili i njëjti e inkriminon të akuzuarin Nesimi Elmasri se ka ndërmarrë veprime me rastin e kryerjes se veprës penale me te cilën akuzohet, për gjykatën nuk ishte kredibile ngase i njëjti nuk ishte i saktë në ato që deklaronte pasi që në deklaratën e dhënë në prokurori në pyetjet e palëve ndër tjerash kishte deklaruar se Nesimi Elmasri "kishte hy në shtëpinë e të dëmtuarit nga dritarja e pasme e shtëpisë dhe kishte dalë nga dritarja e pjesës së përparme të shtëpisë", ndërsa në gjykatë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se Nesimi Elmasri ka hy në shtëpinë e të dëmtuarit nga dritarja e pasme e shtëpisë dhe ka dalë nga dritarja e pasme e shtëpisë dhe ka deklaruar se dritaren e ka parë dhe ka qenë një sipas tij por nuk e din se a ka qenë e hapur apo e mbyllur, i dëmtuari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se në pjesën e përparme të shtëpisë janë tri dritare njëra ka qenë në kiper e dy të tjera të mbyllura, pra deklarata e bashkëkryesit ishte jo e besushme dhe jo bindëse për gjykatën (kontrarverse) kontradiktore në vetëvete. Në këtë çështje akuza e Prokurorisë per veprën penale te vjedhjedhje e rëndë nga neni 327 par.1.nën.par.1.1 të KP -së, mbështetet vetëm ne deklarinim e te bashkëkryersit të miturit E. ... S. ... , në të cilën mbështetet akuza për të akuzuarin Nesimi Elmasri ndërsa nga dëshmitë e tjera te dëshmitarëve te konstatuar më lartë në deklarinimet e tyre nuk e inkrimojnë të akuzuarin dhe nuk janë afruar dëshmi konkrete për te vërtetuar veprimet ne kuptim te përgjegjësisë penale të tij.

Bashkëkryersi i mitur E. ... S. ... , me deklarinim e tij e inkriminon të akuzuarin Nesimi Elmasri, për kryerjen e veprës penale, por në bazë të dispozitës ligjore dhe atë nga neni 123 par.5 te KPP-së, theksohet se gjykata nuk mund ta shpall fajtor të akuzuarin me një deklaratë të bashkëkryersit pasiqë që deklarata e tij është si provë e vetme fajësuese dhe vendimtare për dënimin e te akuzuarit Nesimi Elmasri, dhe kur gjykata në shqyrtimin kryesor si provë

dëgjon deklaratën e personit në cilësi të dëshmitarit i cili në procedurë të mëtutjeshme fiton statusin e të pandehurit kemi të bëjmë me provë të pa pranueshme, pasi që nga prova të tjera nuk mund të vlerësojmë në mënyrë të bindur se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, po ashtu përveç provave personale të dhena nga dëshmitarët, ekzistojnë edhe prova materiale siç është raporti i ekzaminimit AFIS me të cilën nuk janë konstatuar gjurmët e gishtërinjëve apo vijat papilare në mënyrë të qartë që i përkasin të akuzuarit por të aty është konstatuar se është vërtetuar se gjurmet e panjohura të vijave papilare të gishtit të dorës D1, janë ekzaminuar me zmadhues dhe është gjetur se janë të papërshtatshme për krahasim dhe identifikim të metejshëm, gjurmët të panjohura të vijave papilare të gishtit të dorës D2, janë ekzaminuar me zmadhues dhe është gjetur se janë të përshtatshme për krahasim dhe identifikim të metejshëm, është bërë krahasimi - eliminimi i gjurmëve latent të gjetura në vendin e ngjarjes, me shenjat e gishtërinjëve të E. K. ..., ku është konstatuar se gjurmët latent të gjetura në vendin e ngjarjes, me shifrën D2, janë të njëjta me gishtin nr. 6 gishti i madh i dorës së majtë të E. K. ..., andaj edhe mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata duke e vlerësuar personalitetin e bashkëkryerësit të vepërës dëshmitarit E. S. ..., lidhur me besueshmërinë e deklaratimit të tij, e duke u ndërlidhur me këto çështje besueshmëria e këtij deklaratim të bashkëkryerësit nuk do të kishte fuqinë bindëse për gjykatën që i akuzuari të shpallej fajtor.

Provat e proceduara në këtë çështje penale si provat materiale po ashtu edhe dëshmitë e dëshmitareve, gjykata vlerëson se janë në përputhshmëri me vendimin e marrë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi lirues për të akuzuarin, të vërtetuara nga deklaratimet e dëshmitareve, mbrojtjen e vetë të akuzuarit andaj gjykata i vlerësoj edhe me rastin e marrjes së aktgjykimit, duke sqaruar çdo rrethane lidhur me çështjen, duke krijuar një bindje të bazuar në gjykatës me rastin e marrjes së vendimit, se nuk është provuar se i akuzuari të kete kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.1 nën.par. 1.1 të KP-së, Gjykata ka krijuar bindjen e plotë dhe se në mungesë të provave që do të vërtetonin fajësinë ka marrë Aktgjykim Lirues në bazë të nenit 364 par 1 nenpar.1.3 të KPP-së, pasi që vërtetoi se Prokuroria nuk i ka ofruar prova që do të vërtetonin një veprë të tillë penale nga ana e të pandehurit, pasi që Prokuroria e Shtetit në arsyetimin e aktit akuzues, akuzën e mbështet në deklaratimin e bashkëkryerësit të miturit E. S. ..., raportet policore dhe raportin e vendit të ngjarjes ku konstatohet se raportet policore por edhe ai i vendit të ngjarjes nuk mund të besohen si prova materiale që një i akuzuar të mund të shpallet fajtor. Në lidhshmëri me vlerësimin e deklaratimeve të dëshmitarëve të bërë gjatë shqyrtimit gjyqësor, nga provat tjera që posedon gjykata, duke vlerësuar dhe administruar këto prova Prokuroria nuk ka arritur të provoj akuzën me prova të bazuar në mënyrë që të ekzistonte një dyshimi i bazuar mirë, që i pandehuri të mund të shpallej fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

Andaj në bazë të nenit 262 par.1, të KPP-së, thuhet se "Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie,..." siç përcaktohet me këtë dispozite, Gjykata në mbështetje të dispozitave ligjore të theksuara, po ashtu edhe të provave materiale të ofruara duke vlerësuar se nuk është provuar se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet dhe në bazë të nenit 364 par.1 nenpar.1.3 të KPP-es ka marrë aktgjykim lirues për të pandehurin. Andaj në këtë çështje gjykata nuk ka mundur që të pandehurin ta shpall fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi e cila e involvon të akuzuarin N. E. ... se në bashkveprim ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.1 nën. par. 1.1 të KP-së, po ashtu gjykata në rastin konkret ka aplikuar nenin 3 parag. 2 të KPP-së ku thuhet "se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për

çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të Ligjit Penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij”.

Gjykata ka vlerësuar edhe propozimet dhe provat tjera, por ka gjetur se janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale u muarr konform nenit 454 të KPP-ës.

Pala e dëmtuar, për kërkesën pasurore juridike, u udhëzua në kontest të rregullt civil - juridik, në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

Nga theksimet e theksuara si me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1771/16, dt.30.12.2016

Procesmbajtësja
Shyhrete Sopaj

Gjyqtari
Mehmet Ndrecaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit përmes kësaj Gjykate.